



MANUAL NDIHMËS PËR HARTIMIN E NJË PLAN BIZNESI “TË GJELBËR”

Siç dihet, një biznes i gjelbër është një sipërmarrje, e cila shet produkte ose ofron shërbime bazuar në parimet e gjelbërta. Bizneset e gjelbërta kontribuojnë në zgjidhjen e problemeve mjedisore dhe kanë impakt negativ minimal në mjedis. Për të lancuar biznesin tuaj, ju nevojitet zhvillimi i një plan biznesi. Paketa e Nisjes së Biznesit (PNS) përmban një proces të detajuar në secilin hap të zhvillimit të planit të biznesit. Plani i biznesit për sipërmarrjen tuaj të gjelbërt duhet të përmbajë elementët kyç, të cilat janë thelbësorë në nisjen e tij.

Për më tepër, për të patur një ide të praktikueshme si biznes i gjelbër, ndërsa planifikon nisjen e biznesit tënd të gjelbër, ka rëndësi gjithashtu vlerësimi i proceseve të biznesit dhe sjelljeve e praktikave në vendin e punës me objektiv rritjen e efikasitetit të burimeve, prodhimi i pastër dhe reduktimin në maksimum të impaktit negativ në mjedis.

Ky seksion nënvizon disa aspekte të rëndësishme green, të cilat duhen përfshirë në planin e biznesit. Një vëzhgim më i thellë sesi të jenë të gjelbërta proceset e tua, duke përgatitur një Sistem të Menaxhimit Mjedisor (SMM), gjithashtu të rëndësishëm në planin tuaj të biznesit, duke qenë se është i praktikueshëm jo vetëm për Start-Up, por edhe për ato ekzistues.

Elementët Green në Plan Biznesin tënd

Përgatitja e një Plan-Biznesi të gjelbër është një nga hapat më të rëndësishëm në nisjen e një biznesi të gjelbër. Plani juaj i biznesit duhet të përmbajë disa aspekte, të cilat duhen të konsiderohen përpara nisjes së sipërmarrjes. Komponentët kryesorë të biznes-planit, janë të nënrenditura në këtë kapitull. Për të gjithë komponentët e biznes-planit tuaj, ju nevojitet të siguroheni, që i keni shtuar çdo element green të rëndësishëm.

Këto elementë green mund të lidhen me:

- Si mjedisi ndikohet veçanërisht nga çdo element i plan biznesit; psh. në termat e marketingut, ku konsiderohet shpërndarja (transporti në distanca më të largëta do të konsiderohet si më i dëmshëm ndaj mjedisit).
- Si secili element i plan biznesit është i ndikuar nga karakteristikat e gjelbërta të produktit/shërbimit tuaj. Psh.kur do të konsideroni çmimin, ju mund ta vendosni atë më të lartë sesa konkurrenca sepse klientët mund të jenë të predispozuar të shpenzojnë më shumë për një produkt të gjelbërt dhe ju mund të keni një marzh fitimi më të lartë.

Të qenit i gjelbërt është ndërlidhëse, e cila do shfaqet në shumë nënndarje të tjera të plan biznesit tuaj. Gjithsesi, duhet të keni shumë kujdes në specifikimet green nëpërmjet një nënndarje të dedikuar specifikisht përmbledhjes të të gjithë masave të kërkuara.

Komponentët e Plan Biznesit	Qëllimet dhe Elementët Green
Përmbledhja Ekzekutive	Përmbledhja Ekzekutive është një parashtrim i idesë tënde për një biznes të gjelbërt, përmbledhja duhet të nënvizojë veçanërisht elementët green.
Ideja juaj e biznesit	Të gjitha plan bizneset janë të bazuar në një ide. Në përshkrimin e idesë tuaj, ju duhet të nënvizoni çfarë e bën unik si biznes i gjelbër (në produkt/shërbim dhe proces)
Plani i Marketingut	Plani i Marketingut duhet të bazohet në një njohje të mirë të tregut. Pasi e ke njohur tregun tënd, duhet të ndërtoni një plan marketing të bazuar në këto 7 pika kryesore : Produkti, Cmimi, Vendi, Promocioni, Burimet Njerëzore dhe Evidencat Fizike. Duhet konsideruar elementët mjedisorë të pikave të mësipërme ndërsa zhvilloni planin; psh. çmimin, ju mund t'i faturoni një cmim ekstra.
Stafi	Si cdo sipërmarrës, ti duhet të vendosësh formën e biznesit. Një biznes i gjelbër mund të marrë një nga shumë format e mundshme, duke përfshirë dhe atë të një sipërmarrje me një pronar, ortakëri ose kooperativë, psh.; Duhet të peshosh pro dhe kundër secilës formë, përpara se të zgjedhësh më të mirën. Ti duhet të konsiderosh të gjitha detyrimet dhe lejet e kërkuara dhe pastaj të zgjedhësh një politikë sigurimi të përshtatshme; bëj të mundur përfshirjen e detyrimeve dhe lejeve mjedisore
Blerje/Shpenzimet për biznesin tënd	Biznesit tuaj do t'i nevojitet të blejë përpara se të prodhojë ose shesë produktin/shërbimin tuaj. Kur të shpenzosh për biznesin tënd konsidero sa miqësore

	janë me mjedisin materialet ose pajisjet e blera.
Procese të gjelbërta	Të bërit të gjelbërt proceset përfshin një numër të madh elementësh, duke nisur nga sa miqësor me mjedisin janë materialet e përdorur krahasuar me produktin final. Për të siguruar një sipërmarrje miqësore me mjedisin, ju duhet të përgatisni një sistem menaxhimi mjedisor. Ky sistem do të ndihmoj në gjurmimin dhe përmirësimin e performancës tuaj në sektorët kyç si: konsumi energjitik dhe ujit, parandalimi i ndotjes, shpërndarje dhe menaxhimi i mbetjeve.
Kostot	Që të vendosësh një çmim të saktë produktit dhe të përgatisësh një plan financiar, do të keni nevojë të përlllogarisni kostot e produkteve. Kini parasysh, që mund të shtoni disa kosto që në fillim për investime të gjelbërta në material, aftësi, por gjithashtu do të jeni më të prirur në kursimin nga praktikimi i nismave pro mjedisit si psh. reduktimi i konsumit të elektricitetit ose ujit , që përkthehet në fatura më të ulëta.
Planifikimi Financiar	Do të keni nevojë për planifikim dhe monitorim të situatës financiare të biznesit tuaj duke përdorur indikatorë sic janë plani i fitimit dhe plani i likuiditetit. Si cdo biznes tjetër edhe juaji i gjelbër i nevojitet të performojë financiarisht, përndryshe nuk do e keni mundësinë e vazhdimit.
Kapitali i kërkuar për Start-Up	Kur vlerësohet kapitali i kërkuar për Start-Up, do të nevojitet të vlerësohen nevojat e tyre në terma të kapitalit për investim dhe burime njerëzore. Konsideroni elementët e nevojshëm për biznesin tuaj të jenë green ndërsa vlerëson këtë kosto si dhe të qenit realist në të.
Burimet e kapitalit fillestar	Tipet më të rëndësishme të kapitalit fillestar janë investimet e pronarëve dhe huatë. Duhet mbajtur parasysh, që janë shumë institucione që ofrojnë mundësi financimi për biznese green.

Ideja Juaj e Biznesit

Të gjitha bizneset janë të bazuara në një ide. Në kapitullin e mëparshëm, do të kesh identifikuar dhe vendosur për të ndjekur një ide të përshtatshme biznesi. Në përshkrimin e idesë tuaj të biznesit, do të nevojitet të nënvizosh çfarë e bën green atë. Përshkrimi duhet të shpjegojë, cilat sfida mjedisore adreson ideja juaj e biznesit, ose proceset e saj që e bëjnë atë miqësore me mjedisin.

Plani Marketingut

Plani i marketingut tuaj nevojitet të bazohet në një njohje të qëndrueshme të tregut. Duke bërë një studim tregu do të jeni të aftë të identifikoni nevojat e blerësve potencialë dhe të zbuloni sesi t'i plotësoni ato. Ndërsa po kryeni studimin duhet të vlerësoni:

- Kur blerësit tuaj janë të interesuar në blerjen e një produkti/shërbimi miqësor me mjedisin dhe;
- Kur ato janë të predispozuar të paguajnë një çmim ekstra për të.

Duhet vlerësuar dhe përgatitur Plani i Marketingut në bazë të pikave të mëposhtme:

- Produkti – të mirat ose shërbimet e ofruara;
- Cmimi – sa do të jetë vlera për atë që ofron;
- Vendndodhja – Si do t'i arrish blerësit, ku do mund ta marrin shërbimin ose të mirat materiale të prodhuara;
- Burimet Njerëzore – ato që do të diferencojnë biznesin tuaj nga të tjerët;
- Promocioni – si do të informosh për ta bërë sa më aktrativ biznesin tuaj;
- Procesi – mekanizmat e ndryshëm dhe procedurat për të dërguar produktin tek blerësit tuaj;
- Evidenca Fizike – Aparenca e përgjithshme e të mirave të prodhuara, shërbimeve dhe kompanisë.

Të bërit të gjelbërt biznesin tuaj

Të bërit të gjelbërt proceset tuaja mbulon një numër elementësh, duke filluar nga sa miqësor me mjedisin janë materialet e përdorura dhe sesi do të destinohen ato te blerësit.

Që të sigurosh që sipërmarrja juaj të jetë miqësore me mjedisin, duhet të përgatisni një sistem të menaxhimit mjedisor. Ky sistem do të ndihmojë në ndarjen dhe rritjen e performancës tuaj në pikat kyce si psh:

- Konsumi i energjisë dhe ujit – përdorimi i energjisë dhe ujit nga burime të rinovueshme dhe kursimi i tyre nëse është i mundur;
- Parandalimi i ndotjes – Përdorimi i teknikave dhe materialeve me emetim të ulët;
- Shpërndarja – përdorimi i mejteve të transportit miqësor me mjedisin dhe distancat të jenë sa më afër;
- Menaxhimi i Mbetjeve – reduktim, ripërdorim dhe ricklim, aty ku është e mundur.

Kostot

Që të jesh i mundur të vendosësh cmimin tënd dhe të vlerësosh planin tënd financiar, do të nevojitet të kalkulosh kostot e produktit.

Kur të kostoni të mirat ose shërbimet tuaja green duhet të keni parasysh që;

- Disa investime shtesë do të duhen të bëhen në pajisje, leje, aftësi dhe të tjera. Kjo mund të shtojë kostot. Pajisjet e specializuara mund të jenë të nevojshme për t'i kthyer produkt/shërbim në green.
- Por këto investime mund të sjellin kursime në kosto operative. Si psh. instalimi i paneleve diellore në faturën e dritave.
- Një tjetër zgjidhje green mund të ishte blerja e pajisjeve të përdorura me një kosto më të ulët dhe rrjedhimisht ul cmimin me të cilin do të dalë në treg produkti juaj.

Kur të kostoni, konsideroni gjithashtu kostot e një vlerësimi të impaktit mjedisor, certifikimi mjedisor dhe kosto të ngjashme. Kjo do t'ju jap një avantazh në marketing më vonë, por kostot e tyre duhet të përfshihen që në fillim.

Plani financimit

Ju duhet të planifikoni dhe monitoroni situatën financiare të biznesit tuaj. Ju mund të realizoni planin e fitimit dhe planin e likuiditetit dhe vlerësimin e performancës aktuale të biznesit përkundrejt këtyre planeve.

Si të gjitha planet e biznesit, edhe ai green nevojitet të performojë financiarisht, përndryshe nuk do mundeni të vazhdoni, pavarasisht sa i vlefshëm është objektivi i sipërmarrjes.